

TODOR P. TODOROV

HAGABULA

ROMAN

BOTIMET TOENA

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale e Evropës, Integritetit dhe Punëve të Jashtme në Republikën e Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zviceran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit në Republikën e Austrisë, Instituti Goethe, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë, Panairi i Librit në Lajpcig dhe Fondacioni S. Fischer.

TODOR P. TODOROV

HAGABULA

ROMAN

Përktheu nga bullgarishtja: Milena Selimi

BOTIMET TOENA

Autori: Тодор П. Тодоров
Titulli në origjinal: ХАГАБУЛА
Botoi në bullgarisht Жанет 45 (Janet 45), 2022

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Fatjona Selaj
Korrektore letrare: Sonila Kryeziu
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN: 9789928960238

© Todor P. Todorov, 2022

© në shqip BOTIMET TOENA, 2025

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Severinēs, hagabulēs sime

Të gjithë yjet e tjetrit pol tani
m'i zbulonte nata nga qielli,
e polin tonë aq qartë sa veç mbi rrafsh
të detit vezullonte.

Pesë herë ndezur e po aq herë
fikur drita e hënës në fytyrë,
pasi kaluam ngushticën e vështirë.

Kur pamë një mal që së largu duke
e soditur, dukej i zymtë¹, e m'u duk
i lartë sa kurrë nuk kisha parë
një shëmbëlltyrë si ai.

Dante Aligieri, "Ferri", kënga XXVI, nga historia e Odiseut².

¹ *Montagna bruna* (italisht) - mal i errët. Në përkthimin në anglisht të *Longfellow*: i zbehtë (i dallueshëm, i zymtë), në përkthimin francez të *Cioranescu*-t: *noir* (i zi, i zymtë), në gjermanishten e *Streckfus*: *von Dunstumgraut*: i ndriçuar në mjegull, e mjegullt. Të gjitha shënimet në fund të faqes në këtë libër janë të autorit.

² Dante Aligieri, "Komedia Hyjnore", kënga XXVI, nga historia e Odiseut, përkthyer nga Mark Ndoja.

1. HERNANI ËNDËRRON

Një kondor lëshohet mbi oqean. Mezi prek ujin, freski, hir. Gjithçka shkëlqen: krahët dhe qielli, valët zhytur në flakë. Një velë e bardhë shkëlqen në kaltërsi. Në shtëpi, një çarçaf liri, që e fryn era, përsërit të njëjtin refren. Dy duar të qeta, aroma e sapunit dhe e pranverës. Dhe fija e kohës në pëllëmbën e një fëmije. Shkëlqen çdo gjë, toka dhe qielli, shiu, çdo fije bari. Bozhuri hapet kah dielli. Fryn erë, agulicja dridhet, një bletë ulet në lulen blu. Një pikë vese fshihet në gjethen e arrës. Një fëmijë ëndërron flutura të ndriçuara nga rrufeja. Dikush po vrapon. Pasditja ul qepenat mbi grurin, bëhet vonë. Një grua po qan, e larë në hënë. Yjet ndriçojnë lartësitë, xixëllonjat pikturojnë natën. Vera është një nënë dhe bota nuk ka fund. Por këtu diçka po errësohet. Kondori kërkon tokë, një hije ia robëron krahët. Një anije e vetmuar fundoset në det. Gjithçka është larg: rinia, orët, vitet. Vetëm Spanja është e përjetshme, nuk harrohet kurrë. Bubullima ha ëndrrën e peshkut që gëlltiti një të mbytur nga anija. Në zemrën e tigrin lind një dre. Një ciklon i ftohtë përshkon stepën, duke ndjekur ujqër, krilla, gjarpërinj. Shkretëtira po dridhet, diçka në tajgë po hesht. Varkat i lidhin në port. Era pëshpërit një lutje të zezë, peshkatarët veshin çizmet e tyre. Një

HAGABULA

hënë e errët po lind, një diell nga errësira. Dhe këtu bie nata, nga ajo botë në këtë këtu. Hagabula kudo.

Hernani zgjohet i mbytur në djersë. Sytë i ka ende pa shprehje, diku tjetër, përgjumësh. Ai ngrihet në këmbë dhe ecën përgjatë kuvertës. Nata shkëlqen mbi të si një pelerinë e zjarrtë. Vështrohet errësirën përpara. Fytyrën e ka të djegur nga dielli, flokët të shpupuritur nga erërat e jugut e të djegur nga zhegu. Çizmet e tij, të kuqe si gjaku, punuar me lëkurën e salamandrës, kërcasin mbi dyshtet prej druri. Era ia valëvit rrobat, i gudulis lëkurën, i bën kockat të mpihen ëmbël. Hapat e tij thyejnë heshtjen. Sa qetësi e plotë është këtu! Bota humbet, ai ndihet si i vetmi njeri në tokë.

Një kostur i vetmuar kalon poshtë anijes dhe valët e errëta shndrisin për një çast nën shkëlqimin e tij të argjendtë. Atij nuk i intereson flota sipër, sytë i ka gozhduar në fund të detit. Shumë poshtë, diçka po trazon në rërë. Pas dy-tri orësh lundrimi, tashmë toka është e dukshme. Shkëmbinjtë monolitë dhe shkëmbinjtë gri, brigje të lagura në dritën e hënës dhe përtej tyre, pyje të errët si vetullat e një përbindëshi të fjetur.

- Atdhe i zi, mëmë e mrekullive! Ja ku jam! - thërret Kortezi. Vetëm era dhe ulërima e pamëshirshme e pyjeve i përgjigjen atij.

Shkelin në breg, rëra është ende e nxehtë. Pavarësisht nga errësira, gjithçka po bëhet e bardhë. Çdo guralec, çdo kokërr rërë, dritësohet. Ekspedita shkarkon anijet dhe ecën në këmbë përmes rrugës së ngushtë përtej shkëmbit, duke tërhequr kuajt e

ngarkuar me hejbe, armë, harta, busulla, furnizime ushqimore, duhan.

- Salgado! - thotë Hernani.

Salgado, sekretari i tij, mban mjekër të çrregullt, fytyrë e skalitur, flokë të lidhur bishtkali. Ai kthehet ngadalë, nuk duket si një njeri që është zgjuar, por si një somnambul.

Flaka e pishtarëve ia ndriçon sytë, liqene qelqi. Diçka e tmerrshme po zgjohet brenda tyre. Ajo që fshihet atje është e çuditshme dhe e frikshme. Lëkura e tij është çnjerëzisht e zbehtë, ai duket si një asket, një profet i humbur. Për dikë, i braktisur përgjithmonë.

- Ku je, Zot? - mermërit Salgado dhe, pas pak kohe, shton: - Asgjë e mirë nuk na pret.

Pason heshtja. Pastaj, ai thërret përsëri:

- Asgjë e mirë!

Një re e fsheh për pak kohë hënën, bëhet flohtë. Kortezi nuk thotë asgjë, vetëm buzëqesh, por në sytë e tij fluturojnë hijet. Ai është i lodhur, pagjumësia përpin netët e tij. Vetëm tani, përpara mbërritjes e mposht demoni i gjumit. Urdhëron të krijohet një skuadër haitianësh, afrikanësh dhe një grup banditësh spanjollë, kumarxhinj dhe grabitës, të rekrutuar nga shtrofullat e ishujve. Ai jep urdhra dhe disa varka nisen dhe zhduken midis anijeve. Dëgjohen zëra të vrazhdë njerëzish primitivë, pasthirrma, fjalë të ndyra në spanjisht dhe gjuhë të tjera, ulërime, të qeshura të mbytura. Pastaj gjithçka pushon. Shpërthejnë shkëndija, topa zjarri lëshohen mbi vela. Skeletet prej druri kërcasin, psherëtimë, përkulin gjymtyrët,

HAGABULA

kufoma të karbonizuara të hedhura në oqean. Një çast më vonë gjithçka digjet: “Santa Maria”, “Santa Anna”, “San Michel” dhe “San Antonio” dërgohen në ferr. I ndjekin edhe gjashtë anije të tjera, një procesion triumfues drejt hirit. Deti është në flakë.

Sapo kalon kodrën shkëmbore, Kortezi gjen treqind burra dhe trembëdhjetë kuaj, të heshtur nën një qiell djallëzor. Burrat duken të zbehtë nën kupolën e natës, një ushtri fantazmash, duke shikuar lart me sy të lagësht. Luftëtarët e së djeshmes, të rrethuar nga gjakderdhja dhe padrejtësia, tani duken si fëmijë, të frikësuar nga një hije që po afrohet. Çfarë kanë humbur ata? Përse vajtojnë fundin e botës?

“Ku është guximi? Ku shkoi burrëria?”, mendon Kortezi.

Lartësitë ngjyrosen me një shkëlqim të përgjakur, kupolat qiellore flakërojnë. Prifti Domingo ngrihet me duart e shtrira lart, sikur po thërret diçka ose dikë, një martir, që do të përpihet nga çasti në çast nga një humnerë. Retë, si qen të uritur, përtypin kupolën qiellore. Aguilari, pasi heq çizmet, ulet mbi një trung anash, duke përtypur një copë mishi dhe shikon pemët që varen mbi të nga të gjitha anët, majat e tyre të mjegullta sipër tyre. Sapo e vëren Kortezin, ngrihet dhe bën disa hapa. Flokët e tij shkëlqejnë si korbi. Grimcat e rërës, të mbartura nga era, i përplasen në fytyrë. Në yll i vetmuar shpon hapësirën sipër tij. Ai pështyn dhe për një çast të gjithë ngrijnë, duke e gjetur veten në një heshtje të panjohur. Heshtja pëshpërit oguret fatale në zemra, sy më sy me përjetësinë e së panjohurës. Pastaj Aguilari thotë:

- Ja ku është mëma e mrekullive! Ja tek është mallkimi i ferrit!

Ai shikon përreth. Era fishkëllen, nata mbyll grushtin.

- Këta janë shkëmbinjtë ku do të kalbet mishi ynë. Shikoni malin! Ai di një fjalë dhe ajo fjalë është vdekja. I zi është shpirti i kësaj toke, të zinj e të zbrazët do të hapen edhe sytë tuaj.

Burrat heshtin dhe dëgjojnë. Fjalët e Aguilarit ringjallin tek ata atë parandjenjën e keqe që u ka mbërthyer fytyrën gjatë gjithë udhëtimit.

- Ku janë fëmijët tanë të palindur? Kë po përkëdhelin gratë që lamë pas? Prandaj jetuam, për të vdekur të mjerë? T'i lëmë kockat në dhë të huaj? Jo, nuk ka asnjë shpresë këtu, në këtë vend të harruar nga Zoti.

- Mjaft, Pablo! - e ndërpret Kortezi.

- Ti u vure flakën anijeve, e marrtë dreqi! Ti e varrose Spanjën, nuk ka kthim pas, - përgjigjet Aguilari.

- Nuk ka, - pajtohet Kortezi. - Nuk ka bukë të ngrohtë, nuk ka përqaftim nëne, as shtrat të rehatshëm dhe as bark të ngopur, as ngushëllim bashkëshortor, as mish qengji dhe verë, as vatër, as tingull kambane. Shtëpinë e babait do ta shihni vetëm në ëndërr. Jeta e një marinari nuk është e lehtë, ditët e tij janë farkëtuar nga fama e hidhur. Por jini krenarë, bij të Spanjës! Dhe tregohuni vigjilentë! Fati na thërret këtu për një arsye. Do ta fillojmë ngjitjen pas një ore. Pas shpinës sonë nuk ka më shtëpi, nuk ka asgjë. E vetmja rrugë është lart, - shton ai dhe tregon drejt pyjeve përpara.

HAGABULA

Nga qielli i ngrysur po bie hiri i anijeve të djegura. I ftohti djeg lëkurën. Disa copa mbeturinash janë ngulur në rërën e bregut, të hedhura nga valët. Askush nuk thotë asnjë fjalë.

Pas pak, dielli lind nga lindja, oqeani spërkatet nga një dritë e artë. Një tym i zi përhapet mbi shkurre. Burrat shikojnë detin, në barkun e të cilit fundosen varkat dhe zhduken velat. Diku atje, në anën tjetër, janë portet e ishullit, ndriçuar nga dielli dhe tundimi, me prostitutat e tyre, kreolet dhe portorikanet e bukura, me bordelet, *pub*-et dhe shtratin e butë, me ushqimin pikant dhe verën e vjetruar. Edhe më larg akoma, përtej çka kap syri, përtej natës, shtrihet Spanja: lakuriq, e përgjakur, krenare, e prekur nga dielli dhe Zoti.

Bluja shkëlqen. Burrat ngjiten ngadalë lart në një shteg të pjerrët midis shkëmbinjve dhe trungjeve të pemëve. Pa kaluar shumë kohë, ata hyjnë në një pyll të madh. Pasi kalojnë kufijtë e tij, nuk mund të çlirohen nga trazirat, prania e gjetheve, barërave dhe degëve. Ata ndihen të vëzhguar. Ata ndihen të burgosurit jo vetëm të vetes, por edhe të të tjerëve. Që kur kanë shkelur këtu, i ka pushtuar një trishtim i pashpjegueshëm, sikur të vinte nga vetë toka. Zogj të panjohur po cicërojnë nga errësira. Të gjithë i shikojnë hijet përreth dhe mallkojnë në heshtje fatin e tyre, mallkojnë të çmendurin që i la pa rrugë kthimi, pa shtëpi, pa shpresë. Me ecjen përpara zemrat e tyre mbushen me një frikë të paqartë, mosbesimi u hyn

në shpirt. Dita, pak nga pak, ia lë vendin muzgut, muzgu shndërrohet në agim blu, ekspedita vazhdon. Ata kapërcejnë rrënjë, ecin rreth gurëve me forma të çuditshme, një mjegull si qumësht i verdhë u ngjitet këmbëve, ndërsa në tokë, si margaritarë, zjarre enigmatike ndriçojnë herë pas here. Askush nuk i prek ata. Nuk është ende mesditë dhe gjithçka errësohet, perdja e natës së parakohshme zbret.

Befas koha bëhet aq mbytëse dhe e lagësht, sa kuajt mezi ecin, ndërsa burrat janë mbuluar në djersë. Djersa u pikon në sy, ua turbullon shikimin, lë njolla të lagura në këmisha, i bën gojët të thata në mënyrë të dhimbshme.

Një kondor fluturon lart mbi çukë, krahët e tij shpojnë kaltërsinë, shikimi i tij zbret mbi botën poshtë: mbi oqeanin e ftohtë, vijën bregdetare mezi të dukshme rreth malit të zi, masiv, i pafundmë, që lartësohet në mes të botës. Një kërthizë e vetmuar, sy i ngulur kobshëm drejt qiellit.

2. AVEROESI DHE ATLANTIDA

Në të tetat, bota është e ngrohtë dhe ovale si një vezë. Dhe gjithçka shkëlqen: tavolina, muret e bardha të haciendeve, pleqtë flokëbardhë, toka, vetë ajri. Katedralja, kupola qiellore, baret e vogla në rrugicat e ngushta, dritaret, sytë dhe buka, gjithçka shkëlqen.

- Hernando! - thërret babai i tij.

- Hernan! - dëgjon edhe të ëmën nga dhoma në fund të korridorit.

Dëgjohej një tingull, një zog këndon para dritares së hapur. Pastaj heshtje. Babai i tij mban një shpatë në njërën dorë, ndërsa me tjetrën merret me uniformën. Ajo varet e zezë dhe e zhubrosur, një shëmbëlltyrë prej pëlhure dhe metali, në të cilën burri i gjatë po përpiqet të hyjë. Martin Korteze de Monroi. Shumë shpejt do të shndërrohet në kapitenin elegant me pantallona të lidhura xhufkë pikërisht sipër çorapeve, me mëngët e gjata që dalin nga sipërfaqja e shndritshme e parzmores. Bashkë me veshjen, do të shkëlqejë në diellin e ndritshëm në *Medellin*.

- Hernan. Hernandinjo! Për Zotin! - bërtet nëna e tij. - Ka hyrë një flutur në dhomën e gjumit, - thërret ajo duke vrapuar rreth shtratit, tund duart, fundi i valëvitet.

Katalina Altamirano. Ose thjesht Katalina, siç e thërrasin të gjithë. Mami. Kur hyn, ai e shikon sipër shtratit, dielli i pasdites shkëlqen në fytyrën e saj të qeshur. Është verë, ora gjashtë e pasdites. Një dritë e butë mbush dhomën.

Hernani hidhet me shpinë në krevat, shtrin krahët dhe drejton sytë nga dielli. Pastaj i mbyll dhe ndien dritën që depërton poshtë qepallave të tij të ngrohta, duke vizatuar rrathë të nxehtë, lule zjarri dhe ëndrra. Ndonjëherë ai është në shtëpinë e xhaxhait të tij, Felipes. Ai ka një kabinet me një tavolinë pune të madhe prej dru arre, një tjetër të vogël e të ulët dhe bibliotekën e cila rrethon të gjithë dhomën. Librat janë shpërndarë gjithandej, harta të vjetra të Botës së Vjetër, letra, shënime, astrolabe, globe të Tokës dhe qiellit. Të vetët thonë se xhaxha Felipe nuk është mirë mendërisht. Por ai ka një histori tjetër për të treguar. Flokët i ka të shprishur, fytyrën me mjekër, sytë e skuqur që enden nga pagjumësia. Xhaxha Felipe fle pak, pjesën tjetër të kohës germon nëpër atlase të pluhurosura dhe vëllime librash të zverdhur, duke vëzhguar qiellin, yjet dhe çdo flakë që përshkruan natën. Për vite me radhë, kërkon Atlantidën, tokën tjetër, siç e quan ai, i bindur që në librat e lashtë do të gjejë të dhëna për vendndodhjen e saj. Madje ka marrë pjesë në një ekspeditë për pushtimin e ishullit të humbur dhe bëhet për një çast guvernatori i vetëm i tij.

- Ishim njëqind burra, - fillon xhaxha Felipe, - netët ishin të ftohta dhe të zeza. Shiu derdhej mbi ne nga gryka e një qielli, të mbytur në oqeanin e akullit.

Ishim të lagur deri në kockë, të vetëm mes ulërimës së furtunës. Reshjet nuk pushonin prej tri ditësh. Rrufeja na ndriçonte fytyrat, ndërsa stomaku na mblidhej si një top. Bubullimat shurdhuese kërcënonin të thyenin velat dhe t'i vinin flakën anijes. Egjiptiani u ngjit në shtyllën kryesore, mes erës dhe shiut, shtriu krahët drejt qiellit shpërthyes dhe përsëriste fjalë enigmatike, të cilat stuhia i merrte dhe i çonte larg duke i copëtuar dhe shkoqur, derisa tingujt e shurdhët dhe të gjymtuar të ktheheshin në copëza qelqi mbi ujin e trazuar. Nuk kishim shumë shpresa. Atë Silvesteri pyeste në ishte koha për të dhënë kungimin e fundit. “Të ikim nga kjo botë si të krishterë”, tha ai. Shumë nga njerëzit tanë, tashmë të përpirë nga dallgët, kishin përfunduar në ujë. Ishim sa një grusht të mbyturish në barkun e detit. Atëherë e pamë atë para nesh, na u shfaq nga askundi një tokë e bardhë verbuese, krejtësisht e rrumbullakët dhe e pastër. Mbaj mend se si m'u mbushën sytë me lot. Burrat ia ngulën sytë vizionit rrezatues. Pas kaq shumë ditësh verbërie, na u kthye shikimi më në fund. Çfarë bekimi! Atë Silvesteri, i mbetur pa fjalë, qëndronte në bashin e anijes, i tronditur nga ngazëllimi. Shtyrë nga stuhia, rrezikonte të përpihej nga vorbullat e ujit. “Don Felipe, në emër të Kishës së Shenjtë Katolike dhe madhërive të saj, mbretit dhe mbretëreshës së Spanjës, ju shpall guvernator të këtij ishulli të humbur dhe të gjetur tani, që shtrihet nën këmbët tona me mëshirën e vullnetit të Zotit!”, bërtiti ai. Sapo i tha këto fjalë, prifti sikur u hodh vetë në mes të stuhisë, i tërhequr zvarrë, pakthyeshem prej saj. Vetëm një çast më vonë asnjë shenjë nuk

kishte nga trupi i tij. “Amin”, thirri dikush, një tjetër mallkoi. Stuhia e lëkundte anijen herë në njërën, herë në tjetrën dhe burrat mezi mbaheshin në këmbë. Kudo rrotulloheshin trupa mbi të cilët derdheshin ujërat e oqeanit. Britma, të shara dhe lutje. Të gjithë do të ishim mbytur nëse nuk do të kishte qenë egjiptiani. Ai la direkun kryesor, u përkul mbi dallgë e pëshpëriti diçka, sikur fliste me ujin. Pikërisht në atë çast, ishulli përballë nesh u ngrit befaz lart, në ajër, duke përmbytur fillimisht kuvertën, dhe më pas tërhoqi të gjithë anijen lart, larg në qiellin e zemëruar. Pas përfundimit të këtij fluturimi të papritur, u hodhëm përsëri mes dallgëve. Nuk e di sesi qëndronim akoma mbi ujë, por, për çudi, ishim ende gjallë. Të paktën shumica prej nesh. Ne mbijetuan për të parë atë në çka prej kohësh nuk besonim. Nuk kishte asnjë ishull. Ishte trupi gjigant i përbindëshit të detit. Ai u zhyt përsëri në thellësi, trupi i tij rrëshqiti poshtë anijes dhe më pas u hodh përpara, drejt së panjohurës. Lëkura e bardhë i shndriste si kockë, bishti ishte gjigant, uji rrëshqiste nga kurrizi i tij. Ishte peshku më i madh që kishim parë, një leviatan i vërtetë. Krijesa biblike e vendosur atje për të ruajtur kufijtë e botës. Me shumë mundime ia dolëm për ta kthyer drejtimin. Të nesërmen deti u qetësua dhe shumë shpejt u kthyem në portin e Barcelonës. Kishim arritur fundin e tokës.

Hernani shikon xhaxhanë me kureshtje dhe nxiton të pyesë:

- Çfarë ka pas fundit?
- Asgjë për sytë e njeriut, - përgjigjet xhaxha Felipe dhe hedh sytë përtej dritares.

HAGABULA

- Po sikur vërtet të mos ketë asgjë? Nëse toka mbaron dhe fillon humnera? Çfarë ndodh me anijet? Humbasin në humnerë? Ku shkojnë?

- Kush thotë se nuk ka asgjë? Rrufetë ndiznin hapësirën e detit dhe para nesh shtriheshin akoma qindra lega ujë që humbnin midis mjegullnajës. Ujë, që nuk është në asnjë hartë. Përbindëshit i ruajnë daljet e botës që nga krijimi i saj. Askush nuk kalon atje. *Hic sunt dracones*.¹

- Por pse? Nëse ka dalje, ka edhe rrugë, - këmbëngul Hernani.

- Duhet të ketë një arsye pse gjërat janë ashtu siç janë. Nëse bota është një sferë, siç besojnë shumica, nuk mund të mos ketë asgjë nga ana tjetër. Nuk mund të mos ketë më tokë. Por, më dëgjo, Hernan! Kjo është një tokë e shkretë dhe e padukshme. Atdhe i zi, mëmë e së keqes.

- Ose e mrekullisë, - kundërshton Hernani.

- Çfarë?

- Osemëmë e mrekullive. Pasuritë pallogaritshme, nimfa, rinoqerontë. Një magji e paparë nga askush. Ndoshta kjo është arsyeja pse e ruajnë. A nuk është atje Parajsa e Tokës?

- Jo! - thotë Felipe. - Parajsa e Tokës është në lindje, jo në perëndim. Në këtë drejtim nuk ka asgjë të mirë. Është një portë e mbyllur. Është më mirë ta mbash kështu. Matanë është një murtajë. Unë të tregova çfarë pamë. Dallgë pa fund, ujë pa jetë. Pa dritë, pa shpresë.

¹ *Hic sunt dracones* (latinisht) - fjalë për fjalë: këtu ka dragonj. Ky mbishkrim ishte vendosur në hartat e vjetra në fusha të pan-johura, të paeksploruara.

Për një çast heshtin të dy. Një shitës ambulant kalon atypari. Hapat e tij humbasin, për sa reklamon me zë të lartë mallrat e tij. Një grua këndon nga një ballkon aty pranë, zgjat krahët, shtrin çarçafët prej liri. Është vapë, qyteti boshatiset në këtë orë të ditës. Ia nis një fllad. Çarçafët fryhen nga era, ngajnë si velat e anijeve.

Xha Felipe kthjellohet dhe flet përsëri:

- Nuk mund të bësh shaka me Djallin. Të thashë, nëse nuk do të ishte egjiptiani, të gjithë do të ishim mbytur.

- Kush është ky egjiptiani? Çfarë ka bërë kaq shumë? - vazhdon të pyesë Hernani.

Për herë të parë, që kur po rrëfen aventurat e tij në det, xhaxhai i tij buzëqesh. Gëzimi i shfaqet në sy teksa vështron në mënyrë enigmatike nipin e tij. Pastaj fytyra i ngryset përsëri dhe ai nis të tregojë:

- E takova egjiptianin në Kordobë shumë kohë më parë. E pashë në treg. Ishte një gjigant i hollë dhe i gjatë, por në të njëjtën kohë ngjante si një fëmijë. Unë nuk e di nëse një njeri si ai ka moshë. Ai e kthente hijen e vet me kokën poshtë përpara shikimeve të habitura të shikuesve, por kërkonte shumë, prandaj më shpesh sillej rrotull pijetoreve sesa kuvertave të fregatave.² Në Kordobë erdhi për të kërkuar një libër,

² Edhe pse fregata klasike daton nga një periudhë e mëvonshme, vetëm se emri (italisht: *fregata*; spanjisht / katalanisht / portugalisht / sicilianisht: *fragata*; holandisht: *fregat*; frëngjisht: *frégate*) përdoret në Mesdhe qysh në fund të shekullit XV dhe tregonte anije luftarake të tipit galeri, me rrema, vela dhe armatim të lehtë, përparësia e të cilave ishte shpejtësia dhe manovrimi.

kështu thoshte. Ndërsa e shikoja duke rrotulluar hijen e tij kudo, habia ime po shtohet. Për të dëgjova histori të treguara, nga më të pabesueshmet. Kur ishte ende shumë i vogël, shkoi në Egjipt për të studiuar magjitë e lashta me të cilat pastaj zbuste stuhitë, kthente drejtimin e erës, vinte në gjumë detin dhe stuhitë, ngjallte frikë te kafshët e detit. U bë kaq i fuqishëm, saqë çdo kapiten e donte në anijen e tij dhe kështu ai kaloi shumë dete dhe oqeane, shumica prej tyre të panjohura nëpër harta. Pa vende të rrezikshme, të largëta, nga Deti Barents deri në Gjirin e Guinesë. Ai pushonte shirat, largonte retë, zbuste uraganet.

Për një hop, xhaxha Felipe shpërqendrohet. Ai zhytet në kujtime, ose sjell në imagjinatën e tij bëmat e mrekullueshme të egjiptianit, udhëtimet e tij nëpër dete dhe kontinente të panjohura. Pastaj buzëqesh dhe shikon Hernanin:

- Sa arritëm në fund të tokës, egjiptiani foli me qiellin dhe ujin, shqiptoi fjalë enigmatike, bëri me gishta shenja mistike, thirri fuqitë e lashta të kësaj bote dhe ato iu bindën. Kjo na shpëtoi.

Xhaxhai hap një libër të trashë, kontrollon diçka brenda, mërmërit në mënyrë të paqartë dhe ngrihet në këmbë. Ecën nëpër dhomë veshur me robëdëshambër, me krahët pas shpinës. Fillon një histori tjetër:

- Kur isha në moshën tënde, jetova disa muaj te daja në Kordobë. Ai ishte njeri me pozitë dhe jetonte në shtëpinë ku jetonte dikur Averoesi³. Në bodrumin

³ Averoes - emri i latinizuar i Ibn Rushdit (1126 - 1198), një nga filozofët më të mëdhenj arabë. Për një periudhë ai ishte edhe kryetari i gjykatës së Kordobës.

e shtëpisë së tij kishte një furrë ku Averoesi drejtonte ndjekjet e tyre alkimike. Daja im e izoloj furrën, sepse prej saj dilnin aroma të pakëndshme që s'dihej nga vinin. Pas saj zbuloi një dollap në mur, ku ishte një arkë me dru qershie, e gdhendur me arabeska dhe me një ngjyrë të zbehur nga koha. Brenda gjetëm një kapelë prej lëkure deveje, herbarium me gjethe ekzotike, lugë argjendi me një toptë në mes dhe dy letra. Këto ishin sendet më të shtrenjta të Averoesit, që ai i fshehu në këtë vend sekret kur ishte fëmijë. Kapelën që i ati e mbante në shkretëtirën e Magrebit, gjetet, të mbledhura për vite me radhë në pyjet e rrallë të Andaluzisë dhe lugën, që i tregoi se si merkuri bëhet gur filozofik. Dy letrat nuk kishin marrës dhe, më shumë ngjanin me ditarë, që Ibn Rushdi i kyçi më vonë, së bashku me thesaret e tjera, larg syve të njerëzve. Pasi lexoi shënimin me inventarin e shkurtër, daja e tij hapi letrën e parë.

Kaluan dhjetë ditë që kur isha i shtrirë në shtrat. Në mbrëmje, një zog ulet në dritaren time dhe dëgjon. Është një qetësi e padurueshme në shtëpi. Kam ndjesinë se po dëgjoj kockat e mia. I mallkuari shiatik! E gjithë shtylla kurrizore po më rënkton. Pjesa e poshtme e shpinës është e palëvizshme, dhimbja luan si me thikë. Provova pomada dhe bimë mjekësore, kompresë, trajtim me avull, banjë hënore. Magjistarët erdhën nga Afrika, unë piva një qull pa shije ndërsa ata recitonin tinguj grykorë mbi shtratin tim. Atë natë zogu nuk erdhi. Asgjë tjetër nuk ndodhi. Një dërrasë fillon të kërcasë nga çatia. Është lagështirë. Dy ditë më parë u groposa në tokë deri në gjoks. Thonë se e

thata shëron. Brenda pak orësh, të gjithë në Kordoba e morën vesh. Njerëzit mendonin se isha bërë sufi. Por dhimbja mbeti. Tani qielli po bëhet gri. Është ftohtë. Asnjë zog. Më duket sikur i gjithë qyteti po ecën mbi gishta. Ndonjëherë duket sikur qyteti lëviz vërtet. Ngadalë, në mënyrë të padukshme, më në jug, drejt detit, drejt Afrikës, deri në shkretëtira. Netët po bëhen më të qarta, gjithnjë e më të pastra, peizazhi jashtë ndryshon çdo ditë. Po bëhet vapë. Dielli pjek tokën e thatë. Vetëm kockat e mia janë të lagura. Njëherë, në muzgun e mbrëmjes, te dritarja u duk koka tullace e një plaku shpinëpërkulur. Është i shkurtër dhe tulla e tij mezi del mbi parvaz. Sytë i ka shumë të zinj, të qartë, si sytë e një të riu. Duket si një nga ata magjistarët endacakë, sharlatanët dhe astrologët. Ai hedh vështrimin brenda dhe, pavarësisht nga errësira në dhomë, më shikon drejt e në sy. Po përpiqem ta shoh më mirë dhe ngrihem mbi bërryla, por drita e qirinjve bën që imazhi në anën tjetër të dridhet, të zhduket, të pëshijell me nuanca fantastike, siç ndodh në një ëndërr; ose në një mirazh. Kur nuk jam më i sigurt nëse ka ndonjë person aty, koka thatiqe del edhe një herë dhe këtë radhë njoh tek ajo fytyrën e mësuesit Ibn Tufail⁴. Ai është i vjetër sa bota, rrobat e tij janë errësuar dhe grisur; nuk është aspak e qartë se çfarë ka veshur, nuk mban çallmë në kokë, kafka i shkëlqen përmes lëkurës së tejdukshme. Në fillim nuk jam i sigurt nëse është ai. A është një vizion i mendjes sime të sëmurë? Ose një iluzion optik i shkaktuar

⁴Ibn Tufail - filozof arab (1105 - 1185), mësues i Averoesit.

nga muzgu jashtë. A nuk u zhduk mësuesi në stuhinë e shkretëtirës vite më parë? A nuk thanë se e kishin rrëmbyer xhindet, që ai u bë shërbëtor i Mbretit të Zi, një burrë androgjin me lëkurë të errët, që sundonte në thellësitë e shkretëtirës afrikane? I mbyll sytë kundër dritës së diellit që po venitet, ia ngul sytë fytyrës së plakut dhe, kur flet më në fund, nuk ka më asnjë dyshim. Ibn Tufaili i zgjat duart me gishtat e gjatë e të thatë drejtuar lart, sytë e zbardhur. Druaj se lëkura e dobësuar tani do të shkasë nga skeleti i gjallë. Por ai thotë: “Dhimbja vjen nga lart”. Jashtë po errësohet dhe së shpejti nuk mund ta shoh më. A po rri ende Ibn Tufaili fshehurazi pranë dritares, apo tashmë është shumë larg? A po endet i hutuar nën dritare të tjera, duke zvarritur këmbët e zbathura përgjatë sokakëve të Kordobës? Nuk e di ku ka qenë apo çfarë i ndodhi, por duket se dielli dhe vitet ia pinë mendjen këtij trurit ndryshe të lavdishëm. Megjithatë, vazhdoj të ndalem gjatë e të mendoj për fjalët e tij. Kuptimi i tyre do të më bëhet i qartë vetëm vite më vonë.

- Imagjino se si duhet të jetë dukur Averoesi në sytë e mësuesit të tij, Ibn Tufailit, - thotë xha Felipe. - Dhe ndoshta gjërat ishin ndryshe. Ndoshta përshkrimi i mjerueshëm që Averoesi i bën plakut nuk është gjithë e vërteta.

Për një moment, xha Felipe shpërqendrohet, shikimi i tij endet jashtë.

- Përfytyro, - vazhdon ai, - se si Ibn Tufaili i afrohet shtëpisë. Si ngrihet ai para dritares dhe shikon në errësirën e brendshme. Atje shtrihet trupi i zverdhur

HAGABULA

i Averoesit, trupi i një të sëmuri të mbërthyer në shtrat. Në ankth dhe i zhveshur, me një fytyrë të dylltë, me sy që shikojnë në zbrazëti. Qiriu digjet në tavolinën pranë shtratit, ai, i pafuqishëm, bëhet tërë sy e veshë në dhomë duke u dridhur nga çdo trokitje e çdo kërcitje. Fytyra e tij është e shtrembëruar nga dhimbja, goja e tij lëviz në mënyrë të pangushëllueshme, por nuk nxjerr asnjë tingull. Duket si një fantazmë, një krijesë e dënuar me mundime skëterre. Vetëm një mrekulli e zbuloi fytyrën e tij këtu, një pamje në vendbanimet më të shëmtuara të kësaj bote dhe të botës tjetër. Imagjino tani trishtimin në fytyrën e Ibn Tufailit, përfytyro se si mendja e të moshuarit po errësohet dhe vetëm për disa minuta ai plaket me vite të tëra para pamjes së tmerrshme. Njëri nga mendimtarët më të ndritur të shekullit tkurret si një rrush i thatë në shtratin e ngushtë, i frikësuar, i thyer, i humbur. Imagjino dëshpërimin e shokut të vjetër, imagjinoje duke psherëtirë drejt qiellit. Një psherëtimë keqardhjeje që mbart një mesazh të fshehur në veshët e të vuajturit. - Xhaxhai i tij hesht përsëri, mendon për një çast, pastaj vazhdon:

- Gjithsesi, këtë thotë Averoesi në letër. Se çfarë është e vërtetë dhe çfarë jo, e di vetëm ai që kaloi rastësisht në rrugë në të njëjtën kohë.

Letra tjetër supozohej se fliste për diçka krejtësisht të ndryshme, por, vetëm pas disa rreshtave, lidhja me këtë rast u bë më se e qartë.

Kalifi më ftoi një mbrëmje në pavijonin e natës në kopshtin e alcazarit⁵, nga ku qielli me yje shihej më së miri. Ajri mbante erë orkidesh dhe narcisash. Ebu Jakub Jusufi⁶ më tregoi imazhe të pikturuara nga marinarët në anijet e humbura. Imazhe që askush para meje, përveç kalifit dhe marinarëve, nuk i ka parë. Raportet e marinarëve përmbanin të dhëna shqetësuese, të cilat ai donte t'i ndante me mua. Anijet ishin nisur drejt brigjeve perëndimore të Afrikës, por, në vend të kësaj, u gjendën në hapësirat e oqeanit përtej Shtyllave të Herkulit.⁷ Rezultojnë të humbur në largësitë e një deti të huaj. Ndërsa fliste, Princi i Besnikëve më tregoi ditarin e anijes që u gjet midis sendeve të njërit prej kapitenëve. "Allahu është i madh", tha Jakub Jusufi.

15 gusht

Vetëm mbrëmë e kuptuam se ishim shmangur nga kursi. Duhet të kenë kaluar ditë që kur era na rrëmbeu nga brigjet e Afrikës. Nuk ka asnjë gjurmë toke përreth. Asnjë shenjë askund. Vetëm valë dhe hapësira pa breg . Dielli djeg lëkurën, nxehtësia gjatë ditës është e padurueshme. Zogjtë rrallë shihen në qiellin e ndritshëm dhe natën gjithçka ngrin nga i ftohti. Po përpiqemi të gjejmë një mënyrë kthimi pas, para se të humbasim përgjithmonë.

⁵ Alcázar - fjalë për fjalë nga arabishtja: pallati. Kështu quheshin pallatet, ndërtuar nga arabët në Spanjë; më i famshmi është ai në Sevilje.

⁶ Ebu Jakub Jusuf - kalifi i dytë i dinastisë Almohad, i cili ka sunduar midis viteve 1163 dhe 1184.

⁷ Shtyllat e Herkulit - kështu quhej në lashtësi ngushtica e Gjibraltarit, nga ku hyn Oqeani Atlantik.

18 gusht

Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet tona për të ndryshuar kursin, anija vazhdon të lëvizë në perëndim. Druaj se ne, tashmë, jemi shumë larg. Në fushën e bardhë të hartave. Atje, ku të lashtët pikturonin përbindësia. Ekuipazhin e ka zënë paniku. Rezervat ushqimore po mbarojnë.

22 gusht

Kudo që të shkon syri, shtrihen ujëra bojë të zeza pis. Nuk e kemi parë diellin prej dy ditësh. Mjegulla dhe retë mbulojnë qiellin. Tym avujsh përfshijnë anijen. Asgjë nuk duket përtej një hedhjeje guri. Nuk është e mundur të orientohemi sipas yjeve. Lundrojmë nëpër mjegull si në ëndërr.

24 gusht

Mjegulla largohet më në fund dhe kupola me yje shkëlqen mbi ne. Ja edhe hëna, që papritmas varet sipër direkëve. Hëna e zezë, ogur i keq. Përçmon dhe lan ftohtë botën poshtë. Shkëlqimi i saj i errët nxin objektet dhe fytyrat, duke u dhënë atyre konture të reja dhe të panjohura. Diçka po u ndodh marinarëve. Si të magjepsur nga këngë sirenash, disa hidhen në det, të tjerë ulërijnë. Një ulërimë çnjerëzore. Në kuvertë, trupat e tyre u binden ritmeve të padëguara dhe rrotullohen si të pushtuar nga diçka. Asgjë nuk e ndal vallëzimin e tyre djallëzor. Të tjerët humbasin shikimin dhe rrëzohen me ngashërime. Të mjerë, që lëvizin duart në ajër verbërisht. Dhimbja dhe frika

zbresin nga hëna. Çmenduria përthith gjithçka. Pikërisht kur menduam se ishim të dënuar, hëna e zezë u fsheh, përëndoi mes flakësh djallëzore dhe ne nuk e pamë më kurrë.

Vizatimet e kapitenit tregonin një disk të zi, më të madh se dielli, që përshkonte sferën qiellore me hark.

Kjo është hëna e botës tjetër, tha kalifi.

- Si e botës tjetër? - thërret Hernani.

Xhaxhai i tij shikon jashtë për një kohë, atje ku perëndimi i diellit e trash ajrin. Pastaj ai shpjegon:

- Nëse është e vërtetë që Toka është një sferë, siç e kam theksuar tashmë, nuk mund të mos ketë një botë tjetër përtej saj. Hëna e zezë, sipas Averoesit, është shkaku i shumë fatkeqësive, duke përfshirë pakujdesinë dhe verbërinë. Kjo për shkak se rrezatimi i saj i errësirës nuk ka një efekt të dobishëm për lëngjet në trup. Aq më pak për sytë dhe zemrën. Ai rrotullohet rreth Tokës, por në mënyrë të pamundur që të vëzhgohet nga gjysma jonë. Hëna e zezë lind nga perëndimi. Pasi dëgjoi tregimin e kalifit, Averoesi vendosi se ajo ishte shkaku i vuajtjeve të tij. Ai mendoi se pikërisht këtë gjë po përpiqej t'i thoshte mësuesi i tij, Ibn Tufaili. Nisi të llogariste vendndodhjen e saj në mënyrë që në çdo çast të ishte mjaftueshëm larg nga kurthi i hënës së zezë. Gjë që rezultoi e vështirë, pasi Spanja është në buzë të kësaj bote dhe, megjithëse nuk mundemi ta vërejmë, hëna e zezë na shikon vazhdimisht nga skajet më të largëta të perëndimit. E padukshme, por gjithmonë afër.

Duke thënë këto fjalë, xhaxhai hedh shikimin drejt qiellit që po errësohet mbi *Medellin*. Duket sikur i harron hënën, kalifin dhe Averoesin. Mendja e tij endet diku, ai vështron jashtë në heshtje, pa lëvizur.

Hernani është i magjepsur nga ideja e yllit misterioz. Ai dëshiron të mësojë më shumë për hënën ogurzezë, por xhaxhai i tij kollitet, thotë se është koha që t'i njomë këmbët e tij të sëmura në ujë të nxehtë, dhe për Hernanin e vogël është koha të shkojë në shtëpi.

- Por, xhaxha, - kundërshton Hernani, - dua ta zbuloj këtë botë, të shikoj hënën e zezë!

- Oh, djali im, - psherëtin xhaxha Felipe, - nuk është rastësi që Perëndimi ruhet nga dragonj! Nuk është rastësi që ekziston një hënë e zezë. Nuk është rastësi që gjërat janë ashtu siç janë. - Dhe pas një ndërprerjeje të shkurtër, shton: - Kam dëgjuar se diku atje, në zemër të asaj bote, ngrihet një mal i madh. Nga majat e tij rrjedhin lumenj ari, por ata ruhen prej kanibalëve, të cilët, për hyjnitë e tmerrshme, flijojnë fëmijët e tyre. Atje nuk depërton kurrë asnjë diell.

- Por, xhaxha... - flet përsëri Hernani. Në këtë çast, Felipe ngrihet në këmbë dhe e ndërpret:

- Djali im... - Pastaj e shikon me rreptësi dhe përfundon fjalinë: - Ka botë që nuk janë për ne. Ato as nuk kanë qenë, as nuk do të jenë. - Në fund, xhaxha Felipe buzëqesh: - Nganjëherë është më mirë të qëndrosh në shtëpi, - thotë ai. Dhe me këto fjalë i jep fund bisedës.

Kur kthehet në shtëpi, Hernani flet me entuziazëm për bëmat detare të xhaxhait të tij, për hënën e zezë

dhe Averoesin, për malin në anën tjetër të botës dhe tregimet e marinarëve.

- Zemër, - thotë nëna e tij, - xhaxhai yt kurrë nuk e ka lënë tokën.

- Por kalonte shumë kohë nëpër taverna. Atje mund të dëgjosh lloj-lloj historish, - ndërhyt i ati. - I ka sajuar të gjitha vetë nga librat dhe avujt e alkoolit. Si dhe nga tregimet e marinarëve të dehur.

E ëma e shikon me shqetësim:

- Xhaxhai yt ka vuajtur nga dhimbjet e gjurit që kur ishte fëmijë. Deti nuk i bën mirë atij.

Hernani rrudh vetullat i hutuar dhe kthen kokën herë nga njëri e herë nga tjetri.

- Zemër, - thotë ajo përsëri, veç kësaj, xhaxhai yt, Felipe, nuk pati kurrë dajë në Kordobë.

Por, për Hernanin tashmë është tepër vonë. Ai është i vendosur të gjejë egjiptianin, të lundrojë në detet e rrezikshme perëndimore, më në fund, të kalojë përtej meridianit të frikës. Larg, larg në oqean, përtej portave të perëndimit. Zemra e tij po gufon.

Pak më vonë ai shtrihet në shtrat i pagjumë, mendja e tij pikturon tablo të mrekullueshme nga botë të huaja, të pamundura. Lodhja ia pushton trupin dalëngadalë. Nëna hyn dhe vendos një qiri mbi tavolinë. Flaka hedh një dritë të qetë në dhomën e errët.

3. AGUILARI PËRNDJEK MURTAJËN

Zjarri ndriçon fytyrën e Aguilarit, sytë e tij reflektojnë shkëndija të qelqta. Shenja mbi syrin e djathtë merr jetë nga loja e flakëve, një plagë e purpurt. Flokët e zinj i bien mbi supe. Era flladit fytyrën e egër, së cilës vrazhdësia dhe lufta i kanë dhënë një fisnikëri të caktuar, të përzier me mizori. Nuk ka mëshirë te ky njeri, vetëm qëndrueshmëri dhe vendosmëri fatale të vullnetit. Pavarësisht nga kjo, shikimi i tij rrezaton qetësi dhe meditim, ashtu si një ëndërrimtar ose një i urtë. Fytyra e Aguilarit mbetet një mister për shokët e tij: disa tërhiqen nga e pazgjidhshmja në imazhin e tij, të tjerët frikësohen prej tij. Flokët i ka të mbledhur prapa si një flamur primitiv, pisë të zinj, që dalin drejt e nga lëkura, bërë njësh me errësirën përreth. Britma e një zogu dëgjohet nga larg. Burrat ulen në tokë duke parë zjarrin. Lodhja i mposht ata. Armiqësia e kësaj bote ua shpon zemrat. Në fund, ku mendimet zbresin, nuk ka ngushëllim. Një pyll gri i rrethon, indiferent ndaj përpjekjeve dhe shpresave të tyre. Mezi i dallueshëm. Një pëshpëritje del nga degët e vrenjtura. Qymyret kërcasin, një trung i madh bie në një re shkëndijash dhe digjet menjëherë, gllabëruar nga gjuhët e zjarrit.

Aguilari është kapiten në Gardën Mbretërore, kolonel në “Penda e Zezë”, Kalorësi i Shpatës Kastiliane. Luftoi me myslimanët në rrethimin e Granadës, mori pjesë në luftën e Napolit. Ai luftoi për mbretin e Aragonës, mbrojti flamujt e dukës së Akuitanisë. Shenja sipër syrit është nga kama e një mauri që e ndoqi për jetë a vdekje në shkretëtirën e Magrebit. Përveçse lufton për dy korona e gjysmë, Aguilari është mercenar, ndjekës dhe, kur lind nevoja, ekzekutor. Për shkak të guximit të treguar dhe mizorisë në Granada, u lavdërua personalisht nga mbreti. Pranë Napolit, ai u përball i vetëm me një grup prej njëqind burrash dhe u kthye në kamp i mbuluar në gjak, me plagë thike, tërhequr zvarrë nga kali i tij, por e la armikun pa frymë në fushat me diell pranë Vezuvit. Ai luftoi në det, kundër korsarëve dhe piratëve. Ai luftoi edhe në shkretëtirë kundër grabitësve beduinë. Ai luftoi në majat e maleve, i ndjekur nga murgj militantë me sëpata, kryqe hekuri dhe njerëz të frikshëm, që i bënë zemrat e ushtarëve të tij të dridheshin.

Njëherë, baroni i *La Coruña*-s e punësoi për të kapur një bandit, që ishte kthyer në torturë për çdo udhëtar që rrezikonte fatin e tij në rrugët galike. Rrugës për *Santiago de Compostela*, afër *Ordes*, mbërriti në një kënetë. Këneta duhej anashkaluar përgjatë një shtegu që hynte në pyll. Pelegrinëve iu deshën rreth gjysmë ore për të kaluar. Kohë e mjaftueshme për Pedro Kënetorin dhe bandën e tij. Ata kërcyen papritmas nga kallamishtet, me fytyra të

lyera me baltë të zezë, me gjethe të ngjitura, pendë të ndyra, kalbësira dhe papastërti të tjera. Ata i frikësonin udhëtarët, pelegrinët i frikësoheshin Zotit, kështu që rrallë kishte dhunë. Njerëzit besonin se Djalli vetë dhe shpura e tij ishin fshehur në atë vend për të vjedhur të krishterët shpirttrazuar dhe njerëzit e drejtë mendjelehtë, për të cilët ferri është gjithmonë diku gjatë. Hajdutët dilnin nga terri dhe balta si përbindësia, dhe, ndërsa viktimat e tyre kuptonin çfarë po ndodhte, zhdukeshin përsëri në hiç, duke marrë me vete gjithçka me vlerë në këtë botë. Çdo gjë që mund të bartej pa problem.

Aguilari u nis fillikat drejt Ordes, iu afrua kënetës dhe e la kalin në fshatin afër. Ai u nis në këmbë, por, kur fshati nuk dukej më dhe mbeti pas kthesës së parë, u kthye mënjanë dhe eci mes pemëve. Me shpatën e tij priste herë pas here ndonjë kaçubë, ose degë që ia bllokonin rrugën. Pylli u hap para tij dhe ai e gjeti veten në zemrën e tij të errët, ku natyra vetë fshihet nga vetvetja. Aguilari u ngjit në pemë, nxori dylbitë nga çanta dhe priti. Nga ky vend mund të shihje qartë kënetën aty pranë dhe shtegun ndanë saj. Ai e kaloi tërë ditën nën kurorën e degëve të dendura dhe hijen e gjetheve, kurse natën zbriti të shtrihej e të hante mollë dhe bukë. E mbushi pagurin e tij me ujë përroi dhe u ngjit përsëri në pemë.

Nuk priti gjatë. Natën e dytë kaloi një karrocë. Në çastin kur hyri në shkurret e dendura, banda e Pedro Kënetorit doli nga thellësitë e tokës. Një duzinë burra, një klikë e shëmtuar, që ia ka kthyer shpinën racës

njerëzore. Brenda pak minutash bagazhi u shkarkua, qeset u zbrazën, parzmoret u shkëputën, kuajt u shtynë drejt bregut të kënetës dhe karroca u hodh në ujë.

Ajo që Aguilari nuk e dinte ishte se karroca i përkiste dukës së *Wallenstein*-it. Së bashku me të dashurën e tij, konteshën e Silezisë, ai endej i përhumbur rrugëve të harruara nga Zoti. Vrap i kuajve të ngrehur ngrinte lart pluhurin e rrugëve, karroca, një fantazmë e shqetësuar, e pazonja të gjente rrugën e shtëpisë. Si në një rreth vicioz. Nën shenjën e një mallkimi të pashpjegueshëm, të dy kalonin qytete, pyje dhe shkretëtira, e kalonin natën në hane dhe bujtina. Pushonin pranë shkëmbinjve dhe brigjeve, pastaj vazhdonin, ndërsa hëna përvijonte siluetën e karrocës së vetmuar që kalonte qetësisht në natën spanjolle. Askush nuk e di se si arritën kaq larg, deri në fushat iberike. Njerëzit pyesnin veten nëse të dashuruarit po iknin nga diçka, apo nëse ata vetë ishin ndjekësit, gjuetarë të një të vërtete të dashur dhe të humbur. Debatonin nëse, kush e vinte re i pari karrocën, kishte fat apo i sillte ogur të keq. Ajo që të dashuruarit endacakë nuk e dinin ishte se, me të mësuar për tradhtinë, konti silezian i shpalli luftë fqinjit të tij. Por duka i *Wallenstein*-it nuk mendonte për luftën ndërsa kalonte tokat e thata spanjolle. Ja ku janë, dy figura të trishtuara, hije dinjitoze të historisë së treguar në djepe dhe shtretër fëmijësh, për të mbushur zemrat e vogla me një përzierje frike, kureshtjeje dhe eksitimi, eliksir që hap shpejt rrugën e mrekullueshme drejt ëndrrave.

Kur i grabitën në rrugë dhe mbetën pa para, kuaj dhe bagazhe, të dashuruarit u nisën në këmbë

drejt qytetit *Santiago de Compostela*. Karrocieri i tyre, pasi e lexoi grabitjen si një ogur të keq, i la në udhëkryqin e parë. Nxitoi të mbërrinte në muret e Vjenës, ku e prisnin pastat e preferuara me krem dhe ato gratë e bardha si bora, që nuk gjenden askund në Spanjë. Duka dhe kontesha mbërritën të vetëm në *Santiago de Compostela*, me rroba të ndotura dhe të grisura, në cak të fuqive të fundit. Këmbët e tyre të zbathura kishin plagë nga udhëtimi i gjatë, rrobat e mbetura ishin të zbërdhulëta nga dielli dhe shiu, sytë e nxirë, flokët e çrregullt dhe plot me glasa. I pranuan në Vëllazërinë e Zemrave të Pikëlluara, një sekt bredharakësh, të atyre që enden nëpër qytete për të fshikulluar veten në rrugë dhe sheshe. Kushdo që i ka parë, qoftë edhe një herë, nuk i harron kurrë shpinat e përgjakura dhe fytyrat e tyre të habitura.

Një mëngjes në Madrid mbreti pa nga sheshi i mbuluar nga dielli dhe vuri re gjysmë të zhveshurin e mjerë që fshikullonte veten me kamxhik. Vështrimi i mbeti për një kohë të gjatë te një nga burrat përpara, një i mjerë, i zbehtë dhe thatim, me mjekër të ndyrë.

“Aështëkjo Spanja?”, mendoi monarku i tmerruar. Më në fund, iu drejtua kapiten Pablo Aguilarit, i sapoemëruar “Kalorës i Shpatës Kastiliane”, dhe e pyeti:

- A nuk është duka Fon Valënshtajn ai atje?

- Madhëria juaj gabohet, - u përgjigj Aguilari. - Nuk mund të jetë duka. Gjithsesi, vetëm mëshira e mbretit të Spanjës mund të gjejë zemrën e një fisniku te ky shpirt i varfër.

Megjithatë, atë natë, ai pa gjithçka qartë përmes dylbive. Pas grabitjes, banda e çoi plaçkën në shpellë, nga ana tjetër e kënetës. Pastaj burrat u tërhoqën në një kodër, të fshehur pas shkëmbinjve dhe shkurreve me ferra, ndezën zjarrin, pinë, bërtitën dhe kënduan deri në agim. Në një çast, udhëheqësi i tyre hyri në pyll, u ul pranë përroit, lau duart, fytyrën, piu ujë të ftohtë dhe qëndroi pranë një peme të çlodhej. Nga qielli u lëshua një hark. Shigjeta i preku kafkën e kokës, Pedro ndjeu majën e akullit. Një zë foli ngadalë nga maja e pemës.

- Nëse e lëshon harkun, do të ta shpoj kafkën përmes fontanelës. Aty ku koka jote dikur ishte e hapur, do të hapet përsëri. Do të jesh si një fryt i palindur. Për ardhjen tënde në këtë botë do të flasë vetëm shigjeta e ngulur në fytin e tharë. Kafshata jote e fundit. Ajo që nuk do ta gëlltitësh kurrë.

Pedro Këneta nuk lëvizi. Ai qëndroi i ngrirë, pa thënë asgjë. Për një kohë, dëgjohej vetëm mërmëritja e përroit dhe cicërima e zogjve të mëngjesit.

Aguilari vazhdoi:

- Ke dy mundësi. Të vish me mua dhe të shijosh shijen e luftës. Dinakëria e kombinuar me ligësinë do të të bëjë të dobishëm nëse je në anën e duhur. Dëgjo, ata të dehurit nuk janë të mirë. Nëse i lë, ata do të vrasin njëri-tjetrin për çikërrima. Deri atëherë, rojat do ta kenë rrethuar të gjithë pyllin. Askush nuk do të dalë i gjallë.

Kapiteni ndaloi një hop dhe vazhdoi:

- Ose gjithçka mbaron tani. Shigjeta shpon kafkën, sytë shkëlqejnë, trupi bëhet blu. Do të mpihesh për

pak orë. Quhet *rigor mortis*.⁸ Miqtë e tu nuk do të të gjejnë. Jo para se të bjerë muzgu. Por atëherë do të jetë tepër vonë. Dehja nga alkooli do t'i mbajë në shtrat gjithë ditën. Pastaj... pastaj ata do të shtrihen përsëri, por në ndonjë burg mbytës. Do të numërojnë ditët derisa të takojnë xhelatin. Askush nuk do të të gjejë kurrë.

Ja ku është tani Pedro Këneta, i ulur, i mbështjellë pranë zjarrit në një pyll tjetër, në anën tjetër të botës. Ai mbështet mjekrën në gjunjë dhe bredh shikimin përreth, në errësirë. Burrat janë të heshtur dhe të rrënuar. Aguilari është mbështjellë me një batanije, hija e kapelës ia fsheh sytë. Dëgjohet kërcitja e prushit. Dikush thërret:

- Më trego për murtajën. A është e vërtetë që edhe ti ke luftuar me të?

Aguilari ngre kokën, rregullon kapelën dhe nis të flasë:

- Unë nuk luftova, por e ndoqa për një kohë të gjatë. Isha në gjurmët e saj, hap pas hapi. Isha i sigurt se do ta arrija. Por murtaja është e shpejtë. Më e shpejtë se kali dhe më e shpejtë se koha. Asgjë nuk e mposht të mallkuarën. Pashë fshatra të shkreta, qytete-fantazma me grumbuj kufomash në rrugë. Pashë gjithashtu etje, frikë dhe tufa shqiponjash, që e ndiqnin, shpura e saj besnike. Pashë varre dhe burra që s'donin të gënjenin, edhe pse jeta i pati harruar. Dhe unë vazhdova. Sa më shumë i afrohesha, aq më e shkretë bëhej toka përreth. Unë pashë turrat e zjarrit

⁸ *Rigor mortis* (latinisht) - ngurtësi e kufomës.

të të vdekurve dhe dëgjova britmat e të gjallëve, të cilët luteshin të shkonin në botën tjetër. Përpara dhimbjes që s'ikën, më i dashur është fati i qenit të plagosur. Pastaj kali më la. Vdiq në një pellg në rrugë. Ai u shemb në vend, qafa iu këput. Ishte plotësisht i ënjtur, fyti i fishkëllente me dhimbje, mezi merrte frymë. Nxora shpatën dhe, me një të goditur, ia preva kokën, që i përdridhej nga dhimbja. E shpëtova nga mundimi, shoku im besnik. Një pikë gjaku e nxehtë më përvëloi faqen. Dhe ende digjet aty. Një shenjë nga një zemër e egër. Një gjurmë e një miku. Murtaja më kishte ndjekur gjithashtu gjatë gjithë kohës. E kisha fare pranë, po më kapte. Vazhdova në këmbë, udhëtimi u bë i vështirë.

Ndodhte që bridhnim orë të tëra rreth një kënete, ose për të shmangur fshatrat nga të cilat kishte mbetur vetëm tym. Uria u bë shoqëruesi im i vetëm. Pas tri ditësh e gjeta veten në një breg shkëmbor. Nuk dija më ku isha. Nga të gjitha anët ngriheshin shkëmbinjtë të pjerrët. Një mjegull, e dendur si vdekja, mbuloi hapësirën e gjerë të detit. Tufa korbash fluturuan nga shkëmbinjtë për të gjuajtur cofëtinat. Deri ku mbërrinte shikimi, pashë si zogjtë e zinj po zhdukeshin në qiellin e pajetë. Asnjë gjurmë e shpirtit njerëzor. Vetëm një sorrë. Si dhe një diell i errët, gri dhe i huaj, i mbërthyer në lartësi, si një flamur i pikëlluar. Kurrë më nuk e pashë murtajën.

Burrat nuk ia heqin sytë. I hutuar, i habitur, secili prej tyre sheh detin me mjegull, shkëmbinjtë, zogjtë. Të gjithë e ndiejnë të ftohtin që papritmas u është

HAGABULA

futur në shpirt dhe përpiqen të interpretojnë historinë e Aguilarit. Nga pas i vjen një zë:

- Tregomë për vdekjen. A është e vërtetë ajo që thuhet? Ti luftove me të ballë për ballë në një fushë italiane.

Ky është atë Domingo. Ai e ka hequr rasën e leshit ngjyrëkafe, ka lidhur lecka rreth kokës si një çallmë.

- E vërtetë dhe jo e vërtetë. Si çdo gjë në këtë botë, - thotë Aguilar duke hequr kapelën dhe duke e lënë erën t'i përkëdhelë flokët. Mali është i heshtur, burrave u duket se pemët gjigante përreth tyre përkulen gjithashtu drejt zjarrit për të dëgjuar historinë e kapitenit. Ai vazhdon:

- Ndodhi pas Betejës së Paradisos. Fusha ishte nxirë nga kufomat. Kudo që të hidhje sytë shikoje mijëra trupa. Qielli ishte aq i hidhur sa syri i një vejushe. Ne e fituam luftën dhe tashmë, unë dhe njerëzit e mi më të afërt po shëtisnim përreth këtyre kopshteve të zymtësisë. Kudo vinte era kalbësirë. Edhe kuajt shikonin larg nesh. Kalonim pranë karrocave të braktisura me ushqime të prishura dhe mollë të rrokullisura në tokë, që prekeshin nga duar të pajeta. Sa misterioze është vdekja! Pranë tyre shtriheshin armët në përqafimin e barit, në gjumin e pafajësisë. Monumete të lojërave mizore. Kuajt po përparonin mes pellgjeve të gjakut dhe trupave të copëtuar, ishte sikur të ishim në mes të një peizazhi djallëzor. Pastaj i pamë. Ata mbinë nga toka. Në fillim ishin si një re pa trup, një mirazh, pastaj nuk dinim

çfarë të mendonim. Qëndruam aty dhe i pamë teksa afroheshin. Po vinin kalorës të zinj, disa mbanin kapela të çuditshme jonjerëzore, të tjerët kishin lidhur shirita rreth ballit, kishte edhe koka tullace. Të gjithë ata me fytyra si maska të bardha, pa qepalla, me kuaj që nuk kishin as parzmore, as shala. Turma e tmerrshme vraponte mes pluhurit dhe zorrëve, shkelte të vdekurit që i mbulonte dheu. Ai vazhdonte të ecte drejt nesh. Askush nuk tha asgjë, ne nxorëm shpatat, vështroam përpara dhe pritëm. Vetëm atëherë i vumë re këmbësorët. Ata u ngritën në këmbë nga të vdekurit dhe u zvarritën pas kalorësve të tmerrshëm. Kapuçonë me mantele leshi, siç askush prej nesh nuk kishte parë ndonjëherë. Të vdekurit ndërronin rrobat. Të gjithë mbanin në duar shpata bazalti me dorëza të gjata, tehe të mprehta. Armë çnjerëzore të farkëtuara nga shkëmbi. Ne e dinim tashmë se ushtria kundër nesh nuk vinte nga kjo tokë, se këta ishin luftëtarët e botës së nëndheshme. Shpatat e tyre, prodhuar nga zjarri, nga llava e nxehtë, sapo takonin të ftohtin këtu lart shndërroheshin në gurë, fytyrat ftoheshin. Ne qëndruam në mes të fushës, një varrezë e gjallë, duke menduar se nga do të shkonin demonët. A ishin humbës nga ndonjë betejë e tyrja, apo po vinin për ne?

- Ja ku është vdekja! - bërtita me zërin e ngjirur. Kur kalorësit e zinj ndodheshin tashmë njëqind hapa larg nesh, papritmas u fundosën në tokë, njësoj siç mbinë. U kthyen në botën e nëndheshme, duke zvarritur me vete shpirtrat e shkreta që humbën jetën

HAGABULA

në luftën tokësore. Qëndruam me shpatat e mprehura derisa nata ra mbi ne dhe zëri i bufit të zi nuk u dëgjua më në fushë. Pas kësaj qëndruam në pozicione për një kohë të gjatë, pa e ditur nëse ishim gjallë apo kishim vdekur.

Sapo mbaron historinë e tij, Aguilari mbështillet me një batanije, shtrihet dhe i kthen shpinën zjarrit. Burrat rrinë ulur për njëfarë kohe, me sy të ngulur në errësirë. Diku larg pas tyre vjen një ulërimë. Hijet fluturojnë mbi kokat e tyre, krahët dridhen.

Zjarri po shuhet.

4. TAKIM NË ERRËSIRË

Salamanca. Dielli shkëlqen, katedralja shndrit nën qiellin e kaltër. Rrugët mbushen me njerëz. Ndihen aroma erëzash, parfumes, mishi. Hernani është njëzet e një vjeç tashmë, vështrimi i tij endet i shqetësuar, gjithçka vibron tek ai. Vazhdimisht mbërrijnë lajme nga Bota e Re, qyteti gëlon nga thashethemet dhe fjalët e thëna nën zë. Histori të ekzagjeruara nga krikllat e birrës, nga lakmia, nga dëshirat. Kjo është ajo që e lëviz qytetin e madh, historitë dhe ëndrrat pushtojnë shtëpi pas shtëpie, kapërcejnë nga një fat tek tjetri, duke i rrotulluar njerëzit në një valle të ethshme. Derisa gjithçka të vlojë dhe të kthehet në një qerthull të zhurmshëm ku të gjithë ndjekin gjithçka. E tillë është *Salamanca* në këtë ditë, një qytet që ëndërron. Hernani kalon sheshin mes aromave të tezgave të luleshitëses, i buzëqesh një gruaje që në atë moment hap dritaren dhe më pas, i përkëdhelur nga rrezet e mëngjesit, humbet në rrugina. Kur afrohet përpara godinës së universitetit, vëren figurën e mikut të tij, Salgados. Fytyra e tij është e kthyer drejt lartësive, drejt diellit dhe reve të çuditshme. Të dy ndjekin leksione në latinisht dhe astronomi, por Salgado zotëron edhe dy gjuhë të tjera, është i aftë

për korrespondencë zyrtare, njohës i mirë i ritualeve burokratike të monarkisë. I zoti në marrëdhëniet me publikun, tashmë është prezantuar edhe në oborrin e madhërisë së tij. Duket se po përgatitet për një karrierë qeveritare. Por, që kur ishte fëmijë, zemra i ruan një sekret tjetër. Një ëndërr tjetër. Shpesh, teksa djemtë rrihen me shkopinj, ose gjuajnë me gurë, Salgado sodit një milingonë dhe folenë e saj, ndjek gjurmët e kërmijve dhe krimbave. Ai vëzhgon fluturimin e zogjve, vizaton harta të udhëve qiellore. Ai beson se ka gjuhë të tjera që dinë më shumë. Emocionohet nga shkronjat e Egjiptit dhe të Babilonisë. Lexon alfabetin nga trokitjet e qukapikut në lëvoren e pemës. Ai e krahason shkrimin silabik kuneiform të sumerëve me vizat nga sqepat, me prerjet e lëna nga kthetrat e kafshëve të egra. “Gjuha e madhe është në tokë dhe qiell”, thotë Salgado dhe përgjon zërin e brendshëm të natyrës. Aty gjen të vërteta të paëndërruara nga raca njerëzore. Të vërteta të thëna nga britmat e zogjve të natës, nga ulërimat e ujqërve, nga gjëmimi i arinjve. “Ekziston urtësia e shkruar në pluhurin e marshimit të insekteve dhe fluturave që fluturojnë sipër tyre”, mendon Salgado. Ai është i dobët dhe i gjatë, përherë elegant, i vëmendshëm, shpesh i heshtur. Me një mjekër të shkurtër, që ia kornizon fytyrën, sy të errët dhe vështrim vigjilent. Ai mban një bastun oniksi me një kokë luani prej fildishi në fund. Sapo sheh Hernanin, ai tund bastunin dhe bërtet:

- *Vamos, vamos*⁹!

⁹ *Vamos!* (spanjisht) - Le të shkojmë!

Dita është e bukur, qyteti është plot ngjyra. Kudo ka zhurmë. Të dy enden nëpër treg duke biseduar me vajzat, duke inspektuar mallin, duke hedhur mbeturinat e karrocave, tavolinave dhe karrove. Vjen ora kur vapa e mesditës trazon fytin, djeg çatitë dhe lëkurën. Nxitojnë për një hije në tavernën aty pranë, hanë mish viçi dhe pinë verë. Trallisen në vapën e pasdites, pastaj vjen fladi i mbrëmjes. Ka ende dritë, por ajri i lehtëson mushkëritë.

Më në fund, ndahen, sepse Salgado ka takim me rrobaqepësin dhe Hernanit i pëlqen më shumë të endet në hapësirën mes ditës e natës, që zgjon dëshira të parezistueshme të zemrës.

Sapo shpëton nga turma dhe kalon në një rrugë të ngushtë, Hernani ndihet i lodhur. I merren mendtë. Qepallat i dridhen nga vera dhe vapa. Del në *Plaza de Leones* dhe befas bëhet dëshmitar i një skene të çuditshme. Një vajzë vrapon zbathur mbi gurët e sheshit, me këmbë të gërvishtura dhe të baltosura. Edhe pse vrapon, Hernanit i duket se ajo nuk nxiton fare, lëvizjet e saj janë të ngadalta, sikur vizaton diçka në ajër. Flokët e saj ngjyrëvishnje, flakë të gjalla në perëndimin e diellit. E ndjekin një grup dembelësh, lypësish, burrash të dehur, të shoqëruar nga gra dhe fëmijë që bërtasin me zemërim. Shumica mbajnë gurë e shkopinj në duar, disa tundin sfurqet.

- E pashë të lahej në lumë para lindjes së diellit. Shkon atje për marrëdhënie me hardhucat dhe gjarpërinjtë. Djalli e di se ç'ka në bark! - bërtet dikush.

- Shtrigë! - këlthasin të tjerët me sa u ha fyti. E pështyjnë, e shajnë, tundin duart.

HAGABULA

- Në errësirë, ajo endet nga pasqyra në pasqyrë.
Kushdo që e sheh, i nxihet shpirti.

- Ajo ha foshnja! Than zemrat e tyre, i gëlltit si rrush i thatë.

- Vrasëse!

- Ajo nuk ka lindur nga nëna, ka dalë përmes brinjës, nga prapanica.

- Ajo ushqehet me gjak dhe pislleqe në vend të qumështit.

- Në litar! - thërret një prej tyre.

- Mbaje atë! - thotë një tjetër.

Fytyrat shtrembërohen në grimasa kafshësh, nga gojët fluturon pështymë. Thirrjet e tyre pushtojnë sheshin. Ata duan vdekje, ndëshkim. Hëpërhë. Menjëherë dhe në vend. Vajza nxiton e kthehet në një nga rrugicat dhe shpejt humb nga shikimi. Turma e tërbuar nxiton pas saj, por ajo avullon pas qoshes.

- Magji! - rënkojnë ndjekësit.

- Ti, moj zuskë! - fërshëllen një grua e shëndoshë me rroba gjithë yndyrë dhe një thikë kuzhine në dorë.

Hernani kthehet në të njëjtën rrugicë, shikon përreth për siguri dhe vazhdon më tej. Herë pas here ndien afër flokët e kuq të vajzës, por sapo kthen kokën, nuk sheh asgjë. Megjithatë, vazhdon të endet përreth me shpresën për ta parë sërish. Pa e kuptuar, ai ecën pa ndonjë drejtim, i pushtuar nga një mall jonjerëzor. Një parandjenjë e trishtueshme, por e bukur, strehohet brenda tij. I trullosur nga vera, duke bredhur rrugëve të ngushta, humbet. Befas gjendet përballë një kishe të vogël. Ndërtesa është e vjetër, suvaja në mure është

shembur, boja mbi derë është zbehur. Shenjtorët dhe engjëjt e gdhendur pa emër, syzbrazët ruajnë hyrjen. Brenda është errësirë, ajri është i ndenjur, por i ftohtë. Tempulli duket i braktisur. Hernani vendos të pushojë, që të vijë në vete. Pastaj ai do të dalë të kërkojë Salgadon para se mbrëmja të mbështjellë qytetin me ndryshime të reja, para se nata të nisë magjinë e saj të mrekullueshme.

Kisha ka qetësi jotokësore. Hernani pushon në një stol dhe sheh perëndimin e diellit tek përshkon xhamin shumëngjyrësh. Gjithçka është e mbuluar me pluhur, dy trarë varen nga tavani. Një ankth i paqartë e kaplon, ndihet sikur po lundron në një fantazi drite dhe errësire. Por ankthi shpejt ia lë vendin një ndjenje paqeje. Ai ka dëshirë të marrë një sy gjumë dhe e harron shpejt pse ndodhet aty. Vështrimi i tij rrëshqet përgjatë mureve, përgjatë kupolës së kuqe të ndezur dhe nga brenda kah altari. Një pëllumb tund krahët në hijen e qemerit të lartë. Një pelenë i del para syve. Ende pa i mbyllur qepallat, ai kap një shkëndijë të flokëve, të padallueshme nga drita e perëndimit të diellit. Ata vrapojnë si një tufë zogjsh mbi sipërfaqen e pasqyruar të kupës së argjendtë aty pranë. Kisha është e shkretë, gjithçka është marrë ose plaçkitur prej kohësh, por kjo enë shkëlqen anash e harruar. Sikur askush nuk ka guxuar ta prekë. Hernani kthen kokën, por aty nuk ka asgjë. Ngrihet në këmbë. Shikon në qoshtet e errëta, por, përveç tij, nuk ka asnjëri.

Kur takohet sërish me Salgadon, qyteti tashmë po bën kërcimin e tij të vonët. Të dy enden nëpër

rrugët e zhurmshme, rrotullohen në disa pijetore dhe, më në fund, hyjnë në tavernën “Korbi i Zi”, një nga më të vizituarat në *Salamanca*. Këtu mund të dëgjoni e të shihni pothuajse gjithçka. Në qoshe, buzë murit, një burrë i gjatë luan me letra. Përballë tij është ulur një i moshuar me një batanije zheleje. Flokët e plakut janë të bardhë dhe të lidhur bisht. Burri me flokë të gjatë mban një shall të zi në kokë, si pirat. Ndërsa vështron letrat, ai qëndron i përkulur në tavolinë, vetëm herë pas here i hedh një vështrim kundërshtarit të tij. Sapo hyjnë Salgado dhe Hernani, burri kthen kokën, i vështron, ngre vetullat dhe shpejt kthehet në lojë. Të dy ulen dhe porosisin një kanë verë. Salgado ka veshur kostumin e tij të ri dhe duket plot me ngjyra, edhe ekstravagant, por në të njëjtën kohë i rafinuar. Hernani ka një këmishë dhe mantel të zi, sipas modës burgundiane¹⁰. Ai është i shkujdesur dhe ëndërrimtar, mendja e tij endet tjetërkund. Mjekra e çrregullt i jep gjithë sjelljes së tij një pamje të lodhur asketike. Brenda nuk ka ajër, mban erë mishi të pjekur dhe birre. Dyshemeja mban erë thartirë nga vera e derdhur. Dëgjohet tingulli i një violine, ky instrument i mrekullueshëm, i shpikur së fundmi në Itali, që tashmë i ka fituar zemrat në Europë. Salgado përkulet mbrapa, duke parë rreth e rrotull rastësisht. Ai pi një gllënjë nga gota e tij dhe kryqëzon këmbët. Sikur vetë ajri është i magjepsur këtu. Mjegulla pushton

¹⁰ Në gjysmën e parë të shekullit XV, Filipi i Mirë, duka i *Burgundy*-t, prezantoi modën që burrat të visheshin tërësisht me të zeza.

njerëzit dhe ata lëvizin si në ëndërr, gjithçka dridhet në një magji të çuditshme. Drita e zbehtë e qirinje vetëm sa e shton ndjesinë e abstraktes. Papritmas ndodh diçka. I gjati ngrihet befas dhe ia vë thikën në fyt të moshuarit. Ai është një burrë i gjatë dhe i fortë, dhe vetëm gjatësia e tij do të bënte këdo t'i qëndronte larg. Burrat në tavolinat pranë ngrihen po ashtu dhe qëndrojnë mënjane.

- I poshtër! - ulërin gjatoshi me thikën në fytyrën e plakut.

- Kam shpenzuar peson e fundit, nuk kam më para! - përgjigjet ai. - Portofoli im është bosh. Shihe vetë nëse do.

- Më ke borxh edhe dhjetë pesos të tjerë.

Burri me shiritin e zi rrotullon thikën dhe një pikë gjaku rrjedh nga fytyra e kundërshtarit të tij.

- Hiqe thikën tani, Xhoni i Gjatë!

Zëri buçet nga skaji tjetër i tavernës. Tashmë të gjithë sytë janë ngulur andej. Atje është ulur një burrë me flokë të gjatë, pisë të zinj si korbi, me çizme lëkure dhe një kapelë me pendë të zezë ndodhet në tavolinë. Flokët i bien lirshëm mbi supet, sytë e tij duken të egër, të palëvizshëm nga fytyra e atij që e thërret Xhon.

- Nga e di emrin tim? Dhe, pse mendon se do të të dëgjoj? - i kthehet Xhoni të huajit. Nofulla i shtrembërohet, nga goja i rrjedh pështymë si qen dhëmbëskërmitur. Është i dehur dhe, nga përpjekja për të folur, lëkundet.

- Unë jam kapiten Pablo Aguilari, - përgjigjet njeriu me flokë të errët. - Koloneli i Pendës së Zezë dhe Kalorësi i Shpatës. Unë e di atë që duhet ditur.

Sa e thotë këtë, ngrihet vrik, ia del të afrohet me dy hapa dhe tehu i shpatës prek shpinën e Xhonit të Gjatë.

- Jam i bindur se ka edhe një mënyrë tjetër për të arritur një marrëveshje. Vetëm nëse ke vendosur që kjo është ndeshja jote e fundit.

Heshtja mbretëron në tavernë. Të gjithë ua kanë ngulur sytë tre burrave. Atëherë, plaku thërret:

- Kam shërbyer si korrier për një kohë të gjatë. Kam parë mjaftueshëm dhe kam dëgjuar gjithçka. Gjithçka ndodh në rrugën e një njeriu. Askush nuk e di atë që di unë. Lejomëni ta shpaguaj me një histori.

Të gjithë ulen në tavolina dhe kapin gotat e tyre. I kanë hapur veshët, gati si fëmijë të vegjël, për të dëgjuar historinë e të huajit.

- Eja, Xhon! Ulu dhe dëgjo! - urdhëron Aguilari.

Xhoni i Gjatë e heq thikën më në fund dhe ulet duke rënkuar. Korrieri i vjetër e fillon me qetësi historinë e tij:

- Emri im është Henrik Zabaleta. Për shumë vjet kam qenë korrier pranë peshkopit të *Salamanca*-s, njeri i besuar dhe sekretar oborrtar i kontit De Esposito, madje shërbeva për një kohë të shkurtër në oborrin e Madhërisë së Tij, mbretit të Spanjës. Para disa vjetësh ecja me kalë kah rrugës së veriut të *Santiago de Compostela*, me disa lajme nga peshkopi për baronin e *La Coruña*-s. Ndërsa dremitja

në zheg, vura re dy njerëz në rrugë. Burrë e grua që tërhiqnin këmbët zvarrë sikur ishin të sëmurë. Në fillim i pandeha për pelegrinë, pastaj, duke i parë nga afër, mendova se ishin fisnikë, por paraqiten si lypsarë për ndonjë arsye. “Duhet të kenë një arsye pse maskohen”, mendova.

- Mirëdita, zotëri! Çfarë dite është?

- E mirë qoftë! - iu përgjigja dhe u largova me nxitim. Por, para se të tërhiqja frerët, ai thirri përsëri:

- Shoh shenjat e korrierit në kalë, shoh stemën në jakën tënde. Ç’të re ka në botë? Gëzoje udhëtarin e lodhur për pak kohë. Kërkoj edhe një gllënjë ujë. Mirësia jote nuk do të harrohet.

Isha i sigurt se ata të dy s’ishin njerëzit që dukeshin. Ia hodha pagurin e ujit dhe i pyeta:

- Nga ju kemi?

- Nga *Wallenstein*-i, zotëri. Atje ku bëjnë më të mirën *schnapps* dardhe dhe atje ku mbijnë luleshtrydhet më të ëmbla në verë.

- Por jo gratë më të ëmbla, - fola me ironi.

- Të lutem?

- A nuk e keni dëgjuar se çfarë ndodhi me dukën atje? Ka thashetheme kudo.

Burri më vështroi i hutuar, fshiu djersën nga balli me pëllëmbën e dorës dhe tha:

- Të lutem, më thuaj! Kam lënë vendlindjen time shumë kohë më parë. Nga rruga, rrallë dëgjon ndonjë gjë nga kaq larg.

Vura re se shoku i tij po më shikonte me ankth dhe, sapo fillova të tregoja për dukën e gjorë, ata

HAGABULA

të dy u zbehën dhe sytë iu mbushën me lot. Pastaj vazhdova:

- Një mëngjes, pas ngrënies, duka i *Wallenstein*-it urdhëroi të bënin gati një karrocë. Ai i tha shërbëtorit se do të shkonte në liqenin *Schwarzbrüne*, rreth gjysmë dite larg. Hipi në karrocë dhe nuk u pa më. Karroca u ndal përpara shtëpisë së kontit të Silezisë. Atje hipi gruaja e kontit dhe u zhduk me të. Në këto vende dhe muret kanë veshë. Pasi nuk u kthye as në të tretën, as në ditën e katërt, atëherë filloi kërkimi. Kërkimet nisën në liqen, por gjetën vetëm një shelg vajtues me degë të zhytura në ujë. Asnjë gjurmë e dukës. Ndërkohë, konti i ofenduar i Silezisë i shpalli luftë *Wallenstein*-it. Familjarët e dukës pyetën në të gjitha fshatrat dhe qytetet përreth, por askush nuk kishte dëgjuar për të, as nuk e kishte parë. Kur u kthyen, panë se kalaja e *Wallenstein*-it ishte marrë. Shërbëtorët dhe rojat ishin varur në muret e kështjellës. Fshatrat përreth ishin djegur. Burra, gra dhe të moshuar, me foshnja në krahë, vraponin nëpër rrugët me pluhur dhe vajtonin nga dhimbja, nisinin lutje dhe mallkime drejt qiellit. Ata u betuan se, nëse duka do të kthehej një ditë, do të kishte punë me ta për fatkeqësinë që u shkaktoi. Të mjerët u zvarritën nëpër baltë, shkullnin flokët dhe vajtonin fatin e tyre. Hakmarrja e kontit ishte mizore, xhelozia dhe krenaria ia ngrinë zemrën. Kështu përfundoi në mënyrë të palavdishme historia e dukës së *Wallenstein*-it.

Mbarova dhe psherëtiva.

- Më vjen keq, të dashur! - thashë në fund ndërsa po largohesha.

Shumë kohë më pas dëgjova klithmat e burrit fatkeq, të mbetur pa atdhe.

- O Zot! O Zot! - përsëriste ai.

Vazhdova rrugën, por, për ditë të tëra, brenda meje jehuan fjalët e valënshtajnasit të fundit.

- O Zoti im!

Enrike hesht, taverna është e qetë. Dëgjohet zhurma e verës që derdhet në gotë.

- Kur po kthehesha në jug, dyshimet e mia u vërtetuan. Po, zotërinj, ata ishin vërtet vetë duka dhe e dashura e tij. Fillimisht u sulmuan nga grabitësit që u morën gjithçka. Pastaj më takuan mua. Pasi mësuam se çfarë po ndodhte, duka humbi mendjen nga dëshpërimi. Të dy rënkonin dhe zvarriteshin rrugëve derisa sytë e tyre ndryshuan ngjyrë nga pikëllimi.

Në këtë pjesë të tregimit, dikush nga pas psherëtiu.

- Po, zotëri, i pashë vetë me këta dy sy, - thotë Enrike dhe drejton gishtin te sytë. - Ishin bashkuar një procesion mjeranësh që fshikullonin kurrizin me kamxhik. Nuk reshtnin së shari botën me fjalë të ndyra, që vetëm telashe sillte. Në mes të turmës me trupa të sakatuar vura re edhe dukën. Ai ma nguli vështimin, aq sa dallova qartë ngjyrën blu të irisit të syve të tij, që vetëm pak ditë më parë kishte pasur ngjyrën e kanellës. Çmenduria ka sy të tjerë. Duka nuk më njohu. Mendja e tij po fluturonte gjetkë. Nga pamjet më të trishta që kam parë ndonjëherë. Gruaja po ecte disa hapa larg tij. Lëkura e saj ishte si e prerë me thikë. Nga flokët e saj, dikur të parfumuar, tani vinte një erë e rëndë.

Historia e Enrikes përfundon, në tavernë kthehet heshtja. Dëgjohet një kërcitje gotash, dikush mallkon, një qen leh në rrugë. Së shpejti, të gjithë do të kthehen te pija dhe mbrëmja do të vazhdojë sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Kortezi dhe Salgado kthejnë kokën pas dhe vënë re se Xhoni i Gjatë është zhdukur.

Ndërsa mbaron pijen, Aguilari mban të gozhduar korrierin e moshuar. Ai dremit herë pas here dhe sheh përreth me ndrojtje. Kapiteni ngrihet, por, përpara se të largohet, përkul trupin në drejtim të Enrikes dhe pëshpërit:

- Nuk mbaron me kaq, plako!

Korrieri shikon lart, por Aguilari është tashmë në rrugë.

Jo shumë kohë më vonë, edhe dy miqtë largohen nga taverna. Salgado është i magjepsur nga historia e dukës. Nuk resht së pyeturi se çfarë e detyroi të vinte nga Gjermania deri në veri të *Santiago de Compostela*-s. Hernani, nga ana tjetër, mendon për vajzën e sheshit. E përndjek kupa e argjendtë, flokët ngjyrëportokall. Kokën e ka të rëndë nga vera, qyteti i rrotullohet si në ëndërr. Nata me yje zbret mbi ta si një batanije e lehtë magjike. Ndahen kur mbërrijnë tek ura e vjetër romake. Salgado largohet në shtëpinë e tij, pranë universitetit, dhe Hernani ecën në urën e shkretë. Errësira pas tij pëshpërit:

- Hernan! Hernan!

Ai kthehet, por nuk ka njeri në hijen pas tij.

5. I GJATI DHE I ÇALI

Lindja është e vështirë. Fytyra e nënës është e bardhë dhe e ftohtë si mermeri. Buzët e saj po bëhen blu. Babai mendon se mos është koha për të thirrur një prift. Orët kalojnë ngadalë: nata është mbytëse, dita gri dhe e zymtë. Nën dritën e qirinjve, të gjithë duken si fantazma. Klithmat e nënës, lotët e babait, ditë dëshpërimi. Më në fund, një mjek mbërrin nga *Colchester*-i, njëzet milje larg. Karroca ndalet para shtëpisë, ai ecën nëpër baltë me çizmet e tij, me njërën dorë mban kapelën se mos ia merr era, në tjetrën mban një çantë lëkure. Qielli është si i pikturuar me blozë. Së shpejti errësohet plotësisht, fillon të bjerë shi. Doktorin ngjithë shkallët prej druri teksa jashtë bie shi, bëhet më i fortë dhe troket në xhama. Pasi viziton gruan në ethet e lindjes, ai thotë:

- Mundësitë që fëmija të mbijetojë janë *fifty-fifty*¹¹.

Xhoni është me fat, lind një djalë i shëndetshëm dhe i fortë, rritet dita-ditës faqekuq. Nëna e tij e merr veten dhe, shumë shpejt, gjithçka në *Harwich* i rikthehet normalitetit. Gratë lajnë, këndojnë dhe mallkojnë. Burrat punojnë në port, shajnë dhe pinë. Përtej kësaj, Deti i Veriut ulërin i frikshëm me dallgë akull të ftohta ngjyrë hiri.

¹¹ *Fifty-fifty* (anglisht) - pesëdhjetë me pesëdhjetë.

Kur ishte dhjetë vjeç, Xhoni luante me kocka, me topa të vegjël dhe zare. Në port, mund të dëgjosh dhe të mësosh pothuajse çdo gjë. Vitin tjetër shkon e shëtiti tregjeve dhe pijetoreve. Këtu ka, këtu s'ka. Në fillim e rrahin në një han, pastaj disa djem më të mëdhenj e rrahin në rrugë.

Në fund, i ati e rreh keq në shtëpi, sepse ka vënë bast tri pula.

- Nuk do të bëhesh njeri ti. Kërkon telashe përherë.

Një ditë në qytet mbërrin një anije, nga shkallët zbret një burrë me fytyrë djaloshare dhe flokë të bardhë. Ujk i vjetër deti, këmba e majtë e të cilit është ngrënë nga një hidër¹². Mbështetur në një patericë druri, hedhur trupit një mantel të gjatë, ecën ngadalë nëpër rrugë. Askush nuk e di moshën e tij. Në *Harwich* përhapet fjala se ai i paskësh rënë kryq e tërthor Detit të Veriut, paskësh shkuar aq larg, sa ka parë toka të ngrira përgjithmonë në akull. Ndalet te “Syri i Shqiponjës”, një han i vogël pranë skelave. Ai ulet në një tavolinë pranë dritares dhe vështroi detin për orë të tëra, sikur atje po sheh diçka tjetër, të padallueshme dhe të fshehur për të tjerët. Sytë e tij rrezatojnë një trishtim të çuditshëm. Nostalgjia, si një kockë peshku, ka ngecur te ky njeri që nuk i shkëput sytë nga deti.

- Uait. Uilliam Uait.

Kështu e prezanton ai veten kur Xhoni katërmëdhjetëvjeçar ulet në tavolinën përballë

¹² Hidra - një dragua uji në mitologjinë greke.

tij. Për disa ditë, fëmija e shikon të huajin nga larg. Kureshtja e tij nxitet jo vetëm nga pamja e të huajit, por edhe nga gjërat që nxjerr nga një torbë leshi. Pincë bakri, xhama zmadhuese, enë metalike me qëllim të paqartë, një kuti druri me katrorë të çelët dhe të errët, në të cilën rregullon figurina të vogla dhe elegante, një qese lëkure plot me zare, libra dhe, gjithashtu, letra me imazhe të çuditshme, të cilat Uilliam Uaiti i mban në dorë nganjëherë si një freskore, pastaj i vendos mbi tavolinë dhe për një kohë të gjatë ua ngul sytë simboleve misterioze të pikturuara në to.

- Dua të më mësosh, - thotë Xhoni pa i shkëputur sytë nga burri me pelerinë.

- Çfarë kërkon të dish? - përgjigjet tjetri. Sytë e tij vazhdojnë të enden jashtë, në detin e pafund.

- Këtë, - thotë Xhoni dhe tregon nga letrat. - Dhe këtë, - shton ai më pas duke prekur zaret me gishta. - Dua të di gjithçka.

- Mirë.

Burri kthen kokën dhe duket sikur e sheh djalin për herë të parë përpara vetes. I panjohuri me sy të trishtuar i mëson Xhonit të luajë *basset*, *minchiate*, *piquet*, *primus*, *trapola*. Në përgjithësi, gjithçka që luhet në sallonet dhe strofullat e kësaj bote të ngadaltë ku fiton mërzia. Xhonit i pëlqen veçanërisht loja me letra. Secila prej tyre ka një pamje të ndryshme: një kalorës me një mantel blu, një damë me një gotë të artë në dorë, një gaztor me një brokë në shpinë, një skelet me një orë rëre, gjuetarë, një eremit me pendë dhe shishe me bojë shkrimi, një kalorës. Në të tjerat

shikon të vizatuara vetëm kafshë dhe simbole të ndryshme. Shumica e letrave kanë lisa, kërpudha ose zemra shumëngjyrëshe në cepat e tyre me një numër të ndryshëm që tregon vlerën e tyre. Xhoni i mëson përmendësh lehtësisht imazhet dhe kombinimet e mundshme. Shpejt ai bëhet aq i mirë, saqë as mësuesi i tij nuk e mund dot. Nuk kalon shumë kohë dhe bëhet e qartë se askush nuk e mund dot djaloshin, qoftë në letra, qoftë në diçka tjetër, ku fati ka fjalën e vet. Djali thjesht ka fat.

Xhoni fillon të fitojë para nëpër tavernat e portit, në pijetore, skela dhe në të gjitha ato vende ku dembelët sfidojnë fatin. Ai hedh shtat, zgjatet, në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare është një mashkull trupmadh dhe i fortë me nofkën *Long John*, Xhoni i Gjatë, por shpejt e fiton urrejtjen e horrave të regjur, marinarëve të lodhur nga stuhitë dhe përleshjeve trup më trup, si dhe të të gjithë të tjerëve që kanë humbur para dhe krenari në cepat sekretë të *Harwich*-it. Një mbrëmje, një marinar i vjetër, i cili kishte humbur një lojë *primus* me të, e kap për fyti në qoshen e një rrugice të errët. Me një lëvizje, Xhoni ia pret barkun me thikë dhe, për të shpëtuar lëkurën nga banda e marinarëve hakmarrës, fshihet dy javë në një hambar jashtë qytetit. Atëherë, Uilliami i thotë:

- Është koha të largohesh.

- Por, ku mund të shkoj? - pyet Xhoni, që nuk është larguar kurrë më parë nga *Harwich*-i.

- Kudo, - buzëqesh Uilliami. Sytë e tij për herë të parë shkëlqejnë fort, si të ndriçuar nga një diell i padukshëm.

Javën tjetër, në mjegullën e ftohtë, të dy largohen nga qyteti para agimit. Shumë shpejt porti zhduket pas tyre. Xhoni kthen kokën dhe e shikon *Harwich*-in për herë të fundit.

Uilliam Uaiti bëhet agjenti i tij, rezervon takime për të luajtur në qytete të ndryshme, në taverna, sallone dhe tregje, si dhe në shtëpi private. Fama e Xhonit rritet shpejt. Ai është djali që nuk humbet kurrë. Pas Mançesterit, Londrës dhe *Leeds*-it, vijnë Vjena, Parisi, Amsterdami. Pas njëfarë kohe, kur dikush ka fat në letra ose thjesht është fatlum, e pyesin: “Mos je ti anglezi i gjatë?”. Pyetja përmban ironi, pasi të gjithë humbasin në një çast të caktuar. Përveç anglezit të gjatë.

Por suksezi mbart edhe rreziqe. Së shpejti, Uilliam Uaiti është i detyruar ta fshehë “minierën e arit” nën emra të tjerë, t’ia ndryshojë vazhdimisht pamjen, që të mos zbulohet rastësisht, të masakrohet, të grabitet dhe të hidhet në ndonjë kanal. Me paratë nga fitimet, Uilliami pajiset me një protezë elegante, punim virtuoz i mjeshtërve më të njohur holandezë. Ai ecën me ndihmën e bastunit të tij luksoz me dorezë fildishi, blerë së fundmi nga një tregtar i famshëm parizien. Dorëza ka të gdhendur kokën e hidrës për t’i kujtuar atij se çdo sukses ka një çmim. Ndërsa njëri prej tyre troket me këmbën e tij artificiale rrugëve me gur dhe tjetri fiton lojë pas loje, shumë shpejt dyshja e veçantë fillon të njihet me nofkën “i Gjati” dhe “i Çali”.

Megjithatë, të dy përballen me një sprovë kur marrin një letër nga madhëria e tij, mbreti Henri VII i

Anglisë dhe lord i Irlandës, në të cilën sovrani shpreh dëshirën për të provuar fatin me gjatoshin, të cilit fati i buzëqesh gjithmonë.

- Situata është e ndërlikuar, - thotë Uilliami duke e vëzhguar mendueshëm nxënësin e tij. - Nëse refuzojmë, lehtësisht do të fitojmë keqtrajtimin e lartmadhërisë, nëse jo edhe urrejtjen e tij. Nëse luajmë dhe fitojmë, ka shumë të ngjarë të përfundojmë në burg. Por, nëse e lejojmë me vetëdije humbjen, ky do të jetë fundi yt, Xhoni i pamposhtur.

Më në fund, ata i shkruajnë një letër pallatit, në të cilën në mënyrë lakonike raportojnë se, siç dihet mirë, mbreti i Anglisë nuk mund të mposhtet. Prandaj, ata zgjedhin të mos e vënë në provë dinjitetin e shenjtë të monarkut, një guxim që do ta tregonin vetëm perënditë dhe asnjë shtetas vdekatar i kësaj ose i ndonjë mbretërie tjetër. Letra përfundon me konfirmimin se loja e bixhosit me mbretin është e papranueshme, sepse, megjithëse fshehurazi, pranohet dyshimi se bartësi i kurorës është njeri pa fat ndaj rasteve indiferente, si dhe ndaj çdo gjëje tjetër. “Zoti na ruajttë!”, shkruajnë ata në fund të letrës, për t’u shtuar fjalëve të mësipërme një tingëllim më të përunjur që do t’i pëlqente marrësit të lartëmadhërisë.

Megjithatë, aty ku nuk janë në rrezik të menjëhershëm, të dy nuk ndiejnë turp. Xhoni i Gjatë luan me dukën e *Brunswick*-ut, me padishahun osman, me Rafaelon, i cili në këmbim e pikturon në një nga pikturat e tij të famshme, madje edhe me Nikolo Makiavelin në shtëpinë e tij në Firence.